

VENDIM
Nr. 143, datë 16.6.2021

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË W.T.S. - ENERGJI SHPK, PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS NR. 16, SERIA PV04P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 39, DATË
22.7.2004, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 15 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 92/1 prot., datë 14.6.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “W.T.S. - ENERGJI” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të vendimarrjes së ERE-s për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 4.5.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “W.T.S. - Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.7.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshuar me vendimin nr. 26, datë 9.4.2009 dhe vendimin nr. 115, datë 7.10.2013, të bordit të ERE-s.

- Në vijim të kësaj vendimarrjeje, me njoftimin për modifikim licence nr. 6/13 prot., datë 4.5.2021, u krye njoftimi në medien e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “W.T.S. - Energji” sh.p.k.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 617/3 prot., datë 11.6.2021, shoqëria “W.T.S. - Energji” sh.p.k. paraqiti kërkesën për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s, për të mundësuar paraqitjen e disa dokumenteve dhe argumenteve shtesë të kërkuara, në përputhje me rregulloren e sipërcituar.

- Kërkesa e “W.T.S. - Energji” sh.p.k., rezultoi e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative”, i cili përcakton, se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

- Po ashtu, “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 14, pika 3, të saj përcakton, se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “W.T.S. - Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti